

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

Ky është buxheti i vjedhjes më të madhe që një qeveri u ka bërë ndonjëherë shqiptarëve në historinë e tyre. Për të dokumentuar këto që them, ju bëj me dije se gjatë viteve 2005-2013 rritja ishte 530 miliardë lekë, kundrejt vetëm 400 miliardë që është rritja e 9 viteve të vjedhjeve të mëdha. Borxhi publik, që kulmon me vjedhjen më të madhe historike, u rrit me 500 miliardë lekë, në vitet 2005-2013 u rrit me 360 miliardë lekë. Pra, rritja ishte 170 miliardë lekë më e madhe.

Nuk është vetëm kaq, sepse ju rritët taksat, rritja e taksave në këto vite shkon mesatarisht 500 milionë euro në vit, në total shkon 4,5 miliardë euro. Ku shkuan këto para? Në qoftë se me 500 milionë lekë taksa në vit më pak, me një borxh në tetë vjet vetëm 320 miliardë kundrejt 520 miliardëve që morët ju, u ndërtuan rrugë, 1300 shkolla dhe objekte arsimore, 11 vepra të përpunimit të ujërave të zeza, Shqipëria digjitale, me dhjetëra e qindra rrjete kanalizime ujësjellësish, u dyfishuan rrogat dhe pensionet, ndihma ekonomike, po çfarë bëtë ju? Ku shkuan miliardat tuaja, a mund të na thoni? Ku avulluan ato? Rrogat dhe pensionet nuk u rriten, shqiptarët u vidhësën nga njerëzit më të paguar me rrogë mesatare në Ballkan, në rrogën më të ulët. Asnjë punë tuajën nuk u tregoni dot shqiptarëve, që keni përfunduar në nëntë vjet. Asnjë të vetme. Të gjitha janë vazhdimet e punëve që ishin në ndërtim e sipër. Ndërtuat 7 kilometra rrugë autostradë nga Iba në Farkë, me çmim dy herë më të shtrenjtë sesa kilometri i tunelit të Kërrabës. Po si i ndërtuat? Vodhët me thes. Ju nuk keni një objekt të vetëm që t'ua paraqisni shqiptarëve tuaj në 9 vjet. Nuk e mohoj se përfundoi rruga Kardhiq-Delvinë, por si u ndërtua? 7 kilometrat e parë u ndërtuan me 700 mijë euro kilometri. Ju katërfishuat çmimin e saj, sepse vodhët me thes. Tani, pas 10 vjetësh shtoni dhe 16 milionë të tjerë për t'i vjedhur, se nuk jeni ngopur. U ndërtua rruga Lushnjë-Fier me 1,2 milionë euro. U ndërtua rruga Levan – Tepelenë me 1 milion euro kilometri, u ndërtua rruga Levan-Vlorë, autostrada më e gjerë e Shqipërisë me 2 ura mbi Vjosë shumë të mëdha, me 2,2 milionë euro kilometri i rrugës. Po ju çfarë bëtë? Ju ndërtoni në fushë, në të njëjtat kushte, pa ura, me 24 milionë euro kilometrin. Ju vidhni siç nuk vjedh kush në botë. Prandaj ikën ai. E morët vesh se ku shkoi ai, nga parlamenti në “Tropikal”, se do të merret me zgjedhjen e ekipit kombëtar ditën e buxhetit. Ai ka probleme të mëdha me këto vjedhje dhe sa herë përmendet paraja, atij i dalin vjedhjet para.

Ky është buxhet katastrofe. Si arrini në këtë shkallë? Çfarë iu bëtë bizneseve? Iu morët 500 milionë euro në vit më shumë, prandaj edhe ato përfunduan nga 200 e 10 mijë në 107 mijë sot. I falimentuat njëra pas tjetres. Me paratë e tyre frytë një nomenklaturë të cilën Shqipëria nuk e ka pasur kurrë.

Çfarë u bëtë shqiptarëve në pandemi? Çfarë ndihme u dhatë mijëra shqiptarëve që u kuruan në shtëpitë e tyre, se nuk i shtronit në spitale, kur mesatarja e shpenzimeve në shtëpi ishte 1 mijë dollarë për një të sëmurë? Çfarë ndihme u dhatë bizneseve për pandeminë, për naftën? Asgjë. Madje për naftën ju iu ofroni taksën 17%.

Të gjithë do të jenë në datën 12 t'u bëjnë gjyqin në Tiranë, sepse nuk shkohet më kështu. A janë të vërteta këto? Ja, e ulin kokën, se sigurisht mendojnë se nuk i shohin në televizor. Ansambli i vjedhjes është ky mbrapa, se nuk është vetëm ai, se këta vjedhin në zinxhir.

Na tregoni pak për rrugën Qafë Plloçë-Qukës, se ju del mosbashkimi me kilometra të tëra, se vidhni dhe vetëm vidhni.

A e dini se çfarë kanë bërë së fundi? Kanë bërë një akt të turpshëm, që nuk e ka bërë kurrë një shtet. I kanë premtuar Italisë me shkrim, zonjëza, se do të votojnë për ekspozitën botërore në vitin 2030. Shkon e i merr ryshfetin tjetrit dhe i tërheq mbështetjen. Çfarë fytyre keni ju si qeveri kështu? A mund të veprohet në këtë mënyrë?! E kam burim 100% të sigurt. Histori turpi! Ia keni dhënë me shkrim një vendi që u ka dhënë miliarda shqiptarëve nga vitet 1990 deri sot, një vendi ku shqiptarët vetëm biznesmenë janë rreth 50 mijë dhe rreth 40 mijë kryejnë studime. Kënaqeni me ryshfetin në xhep dhe e anuloni. Po ju e turpëroni këtë vend, ndaj ikin shqiptarët se e keni bërë Shqipërinë një vend të pavlerë, e keni ofenduar dhe poshtëruar, kurse për vete jetoni në luksin më të madh. Udhëton ai si sulltan, në luksin më të madh.

Po ku ka kohë këtu? Data 12 po afron dhe po vazhduat kështu protesta tjetër do të jetë para Kuvendit. Respektoni rregullat!

Pra, avioni me dhomë gjumi. 137 udhëtime, edhe për të parë superbawling në Florida, edhe për të bërë vakancat në Paris, e për të gjitha të tjerat. Çfarë buxheti është ky? Prandaj ia mbath ai dhe nuk rri këtu, ikën se i numërohen vjedhjet, por edhe ju jeni bashkëvjedhës, në qoftë se nuk e denonconi këtu, por duhet të dilni.